

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

1. **OBJEKTI:** Këto kushte të përgjithshme kanë si objekt normat për regjistrimin në shërbimin Revolution të Easy Market CRS, apo siç do të riemërtohet më pas Revolution, i cili rregullohet, përveç se nga këto Kushte të Përgjithshme edhe nga Kërkesa për aderim në Shërbim. Përdoruesit i kërkohet gjithashtu të marrë parasysh kuadrin ligjor dhe teknik të vendosur në çdo funksion të pranishëm në faqen e internetit www.easymarket.travel si dhe mund t'i kërkohen Easy Market-it në çdo kohë. Shërbimi i ofruar nga Easy Market sh.a. i lejon Agjencive të Udhëtimit, apo siç do të përmenden më vonë “Përdorues” (Agjenci udhëtimi e pajisur me Leje) të:

- Përdorë produktin dhe të kryejë prenotime në ofertat e shumta të pranishme;
- Konsultojë sistemin Revolution dhe të prenotojë paketat e udhëtimit të pranishme në linket e sistemit si dhe të prenotojë biletat për fluturimet e linjës (duke mbajtur komisionet e përdorimit të Kompanive Ajrore) dhe fluturime low cost, me të drejtë të vendosjes së lirë të Agency Fee);
- Përdorë asistencën telefonike që Easy Market ofron duke telefonuar numrat 0541 797510 (tregtare) apo duke shkruar tek sales@easymarket.travel

Easy Market sh.a. ruan të drejtën të zgjerojë dhe ndryshojë gamën e funksionaliteteve të ofruara brenda shërbimit nëse, nën dritën e funksionaliteteve të reja specifike e të mundshme, do të rezultojë e nevojshme një plotësim për këto Kushte të Përgjithshme dhe për Kërkesën për Aderim në Shërbim, apo një përshtatje e tyre. Easy Market sh.a. do t'i komunikojë risitë e sipër përmendura në mënyrën e konsideruar të duhur. Easy Market sh.a. ruan të drejtën për të ndryshuar karakteristikat e funksionalitetit të Shërbimit apo të eliminojë disa të tilla. Janë në ngarkim të përdoruesit kostot telefonike të lidhjes në pikën e aksesit, që duhen korresponduar me furnitorin e vet të Shërbimit të telefonisë.

2. **KOHËZGJATJA E KONTRATËS:** përdorimi i sistemit është falas. Regjistrimi mund të bëhet nëpërmjet procedurës “registrazione” (regjistrim) e pranishme në faqen e internetit të kompanisë www.easymarket.travel dhe pranimi të mëtejshëm të kushteve të përgjithshme dhe të përcaktimeve sipas Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar; pranimin e kushteve të përgjithshme dhe nënshkrimin e kontratës së ofrimit vjetor të Revolution. Kontrata

konsiderohet e pranuar ligjerisht mes paleve, nese dergohet permes adreses perkatest te e-maio commerciale@easymarketers.it, te kesaj kontrate te nenshkruar dhe vulosur nga agjencia, shoqeruar nga aprovimi i Kushteve te Pergjithshme (nenshkrimi, vula), nga kopje e Autorizimit te ushtrimit te aktivitetit si Agjenci Udhetimi (Leja) dhe Regjistrimi ne Zyrën e Turizmit qe deshmon ushtrimin e rregullt te ketij aktiviteti nga ana e perdoruesit.

3. **AKTIVIZIMI DHE PEZULLIMI:** Kontrata perfeksionohet ne momentin kur Easy Market S.p.A. ofron sherbimin ne baze te pranimi online te kushteve te kontrates nga ana e Perdoruesit. Ne rast ndryshimi te kushteve teknike dhe normative per ofrimin e Sherbimit, Easy Market sh.a. ka te drejten dhe fuqine te nderpresë ne çdo moment ofrimin e Sherbimit, pas një paralajmërimi prej 15 ditësh te njoftuar ne posten elektronike, ne adresen e njoftuar ne kete kontrate.
4. **SIGURIA:** Aksesin ne Sherbim lejohet nepermjet një kodi identifikimi te klientit, caktuar nga Easy Market sh.a. dhe një fjale kyç (janë te vetmit per te gjitha funksionet e perfshira ne Sherbim). Klienti duhet te ruaje Fjalëkalimin (Fjalëkalim), zgjedhur nga Perdoruesi ne momentin e regjistrimit; keta elemente identifikues do te ruhen me shumë kujdes, duke mbajtur te fshehte per gjithë kohëzgjatjen e abonimit qofte kodin, qofte fjalëkalimin. Gjithashtu klienti duhet te tregojë po atë kujdes, referuar elementeve identifikues te identiteteve te mëtejshme te abonimit, per te cilat është titullar dhe qe ka aktivizuar. Klienti do te jetë gjithashtu ekskluzivisht pergjegjes per çdo dëm te shkaktuar nga njohuria d.m.th. nga perdorimi i Fjalëkalimit apo UserID-së, edhe per identitetet e shumta te aktivizuara, nga ana e palëve te treta. Klienti impenjohet t'i komunikojë menjëherë kompanisë Easy Market sh.a. vjedhjen e mundshme, humbjen, apo përvetësimin me çdo titull nga ana e palëve te treta, te Fjalëkalimit apo te UserID-së referuar edhe identiteteve te shumta te aktivizuara.
5. **GARANCITË:** Klienti garanton qe çdo material apo mesazh i nxjerrë ne zona publike te Revolution, qe çon tek ai, si parashikohet me nenshkrimin e kontrates, është ne pronësinë e vet dhe/apo ne disponibilitetin e vetë juridik, çka detyron klientin te dëmshpërblejë dhe te zhdëmtojë kompaninë Easy Market sh.a. ne rast dëmi, nga çdo pasojë e mundshme juridike. Klienti garanton gjithashtu se ky material nuk shkel apo thyen asnjë te drejtë autori, markën tregtare, patentën apo te drejta te tjera qe rrjedhin nga ligji, nga kontrata apo e drejta

zakonore. Klienti vihet në dijeni të faktit se është e ndaluar që të përdorë apo t'u kalojë në përdorim të tretëve Shërbimin kundër moralit dhe rendit publik apo të shkaktojë ngacmime të qetësisë publike apo private, të ofendojë, apo dëmtime të drejtëpërdrejta dhe jo vetëm, si dhe të shkelë sekretin e mesazheve private. Ndalohet rishitja e këtij Shërbimi tek palët e treta; në çdo rast informacionet e dhëna nga klienti nuk duhet të përmbajnë forma apo përmbajtje me natyrë pornografike, të pahijshme, blesfeme, apo shpifëse. Ndalohet shprehimisht gjithashtu përdorimi i Shërbimit për shkeljen e ligjeve në fuqi të Shtetit **italian** (shqiptar) në mënyrë direkte apo indirekte apo të ndonjë Shteti tjetër. Easy Market sh.a. ruan të drejtën për ta ndërprerë kontratën në mënyrë të menjëhershme sipas nenit 10 të poshtëpërmendur, si dhe të drejtën ta marrë Shërbimin në ruajtjen e saj sa herë që ka arsye apo prova për një shkelje të detyrimeve nga ana e klientit.

6. **PËRDORIMI I SHËRBIMIT REVOLUTION:** Klienti mund të përdorë falas Shërbimin Revolution nëpërmjet regjistrimit sipas specifikave lidhur me çdo funksion. Në mënyrë të veçantë, funksioni “Akses” mund të përdoret për një Përdorues / Agjenci të vetme, nuk mund të bëhen disa lidhje njëkohësisht nga seli të tjera të vetë Agjencisë por mund të kryhet më tepër se një akses nga terminale të ndryshme të së njëjtës seli. Në çdo rast përjashtohet mundësia për t’ia shitur kontratën e abonimit të tretëve, falas apo me pagesë, përkohësisht apo përgjithmonë, pa miratimin me shkrim nga ana e Easy Market sh.a.
7. **DETYRIMET E PËRDORUESIT:** Përdoruesi / Agjencia e udhëtimit zotohet të përdorë Shërbimin të paktën gjatë periudhës së provës, për të mundur të testoj funksionet e sistemit. Easy Market sh.a. ka të drejtë të ndërpresë me efekt të menjëhershëm ofrimin e shërbimit, duke çaktivizuar në çdo moment UserID e aksesit të Përdoruesit.
8. **DOKUMENTACIONI DHE IDENTIFIKIMI I KLIENTIT:** Referuar funksioneve që kërkojnë lidhjen në rrjet, klienti vihet në dijeni dhe pranon ekzistencën e regjistrimit elektronik të funksionimit të Shërbimit, hartuar dhe ruajtur nën kujdesin e Easy Market sh.a. Përmbajtja e Log. ka karakterin e sekretit absolut dhe mund të zbulohet vetëm dhe ekskluzivisht me kërkesë të Autoritetit kompetent. Me qëllim identifikimin e sigurtë të prejardhjes së lidhjes, klienti vihet në dijeni të faktit se Easy Market sh.a. e identifikon

Përdoruesin në momentin e lidhjes në rrjetin Easy Market, nëpërmjet kodit të aksesit, të përbërë nga UserID dhe Fjalëkalimi i vet Përdoruesit.

9. **KLAUZOLA E ZGJIDHJES SË KONTRATËS:** Në gjithë rastet e mospërbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga nenet 4,5,6,7 të kësaj kontrate, Easy Market sh.a. ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë, duke shqyrtuar, në çdo rast, veprimet e vlerësimit të dëmshpërblimit për dëmet e pësuar.

10. **KOMUNIKIMET:** Të gjitha komunikimet lidhur me kontratën, do të dërgohen në adresat e postës elektronike të dhëna klientit dhe vëna në dispozicion nga Easy Market sh.a. për shërbimin Revolution: Easy Market sh.a., Rruga Konsullore 51/C, 47900 Rimini (I); Tregtare: Tel. 0541 797510- Faks. 0541 489985- sales@easymarket.travel
www.easymarketcrs.it.

Në bazë të nenit 686 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i nënshkruari deklaron se është vënë në dijeni për kushtet e përgjithshme të kontratës dhe se pranon shprehimisht: pika 3. Aktivizimi e ndërprerja, 4. Siguria 5. Garancitë, 6. Përdorimi i abonimit, 9. Klauzola e zgjidhjes së kontratës së Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.